

## Seminari- Politikat mjedisore të Mega qytetit dhe menagjimi mjedisor

Seminari i organizua në Hotelin Swiss Diamond, më 05 Janar 2012, në Prishtinë nga JAAK dhe JICA. znj. Lindita Haxhimehmetaj, nga Kompania Rajonale e Mbeturinave të Mitrovicës, "Uniteti" Sh.A. ish pjesëmarrëse në trajnimin e JICA, prezantoi përvojat e veta të marra në Japoni për çështje të menagjimit mjedisor në qytete të mëdha.

Në seminar morën pjesë përfaqësuesit e përfaqësuesit e zyrës së JICA në Kosovë, MMPH, MPMS, Danish Refugee Consil, Kompania Regjionale e Mbeturinave; "Uniteti" Mitrovicës, "Pastrimi" e Prishtinës, "Çabrat" e Gjakovës, zyrtarët e komunës së Mitrovicës, prof. të U.P.



dhe student.

### Konkluzat

- Kompletimi i legjislacionit për mjedis
- Fuqizimi i politikave mjedisore në nivel lokal
- Forcimi i Sistemit menagjues mjedisor me theks për mbeturina
- Bashkëpunimi mes palëve me interes



## Fokusi i JICA

### për Objektivat e Mijëvjeçarit

Shumë projekte të JICA kanë për qëllim të ndihmojnë, për të arritur objektivat, si që është ulja e varfërisë dhe urisë, përmirësimin e arsimit, duke eliminuar pabarazinë gjinore, mbrojtjen e nënave dhe fëmijëve të të sapolindur, stabilizimin e mjedisit dhe krijimin e partneritetit të ri global midis vendeve në zhvillim, donatorëve tradicional, organizatave joqeveritare dhe ndërmarrjeve private.



**OZHM; Premtimet më të rëndësishme kolektive të bëra ndonjëherë për shtresat më të ekspozuara në botë**

### për Biodivezitetin global



Në çdo masë biodiversiteti në botë, flora dhe fauna e sajë është në krizë. Me mija specie janë të rrezikuara. Në një takim ministror në

Nagoja të Japonisë, ekspertët dhe politikanët planifikojnë, përpjekje të reja, për të ndaluar shkatërrimin e biodiversitetit në Japoni. JICA është ngarkuar për të ndihmuar vendet në zhvillim dhe popullatën e tyre, ku viteve të fundit i është kushtuar vëmendje marrëdhënies të ndërsjella mes trashëgimisë natyrore të globit dhe shëndetit të komuniteteve lokale. Ajo ka investuar rreth 2.4 miliard dollarë, që nga fillimi i Mijëvjeçarit për Zhvillim, duke zhvilluar projekte për ruajtjen e shumëllojshmërisë së biodiversitetit, filluar nga mbrojtja e shkëmijve nënujor- koralet dhe pyjeve riziofore dhe programe për sigurinë e ujit.



JAAK  
JICA Alumni Association of Kosovo

Nr. 6

## Së bashku me JICA



# SEMINARET

## Takimi rajonal i JICA Alumnit e Ballkanit

Takimi rajonal u mbajt në Tiranë, Shqipëri, më 09 Dhjetor 2011.

Qëllimi i këtij takimi ishte, shkëmbimi i

përvojave në mes të JICA Alumnitë e Ballkanit dhe diskutimi mbi planifikimin e aktiviteteve për të ardhëmen.

Në këtë takim, JAAK u përfaqësua nga dr. Jehona Shalqini, JAAK dhe znj. Arbërore Riza,



koordinatore e zyrës së JICA në Kosovë.



Për të zgjëruar bashkëpunimin rajonal, në mbyllje të takimit, të gjitha vendet u dakorduan për të hartuar një strategji për bashkëpunimin midis JICA Alumnit e Ballkanit, që do të përmirësonte dhe do të ipte një orjentim për punën e ardhëshme.

## Seminari; Menagjimi i Spitalit TQM-për të nesërmen më të mirë, për të gjithë”

Seminari u mbajt në Hotel Grand, Prishtinë, më 17 Nëntor 2011, i organizuar nga JAAK dhe JICA nën mbështetjen e MSH.

Z. Xhevat Ukaj prezantoi përvojën e vet të fituar për këtë temë në trajnimin që ka ndjekur në Japoni.

Qëllimi i këtij evenimenti ka qenë paraqitja e përvojave, të fituara nga trajnimi i cekur para institucioneve të Kosovës. Përveç përfaqësuesve të JICA, zyra e Kosovës, në seminar morrën pjesë Dr. Prof. Ferid Agani, Ministër i Ministrisë së Shëndetësisë, Dr. Ilir Tolaj, Sekretari i Përgjithshëm i MSH, Dr. Skemder Sylja, përfaqësues i OBSH-zyra në Kosovë, pjesëmarrës nga organizatat shëndetësore të Kosovës dhe 4 përfaqësues të mediave që kanë mbuluar këtë ngjarje.

**Znj. Yumi Yasuda**, Eksperte/këshilltare e ODA-s, e hapi seminarin dhe informoi pjesëmarrësit për projektet që janë zhvilluar në Kosovë nga viti 2009, qëllimi i të cilëve është ngritja e kapaciteteve njerëzore, të institucioneve shëndetësore në Kosovë.

**Dr. Prof. Ferid Agani**, Ministër i Ministrisë së Shëndetësisë, faleminderoi qeverinë japoneze për mbështetjen që i ka dhënë institucioneve të Kosovës e në veçanti Ministrisë së Shëndetësisë, “ Është një kënaqësi që marrë pjesë në këtë seminar, pos së cilës do të fillon një fazë e re e bashkëpunimit. Ky bashkëpunim ka një rëndësi të veçantë, sepse kjo hap mundësi të reja të bashkëpunimit”

## Environmental managing process in mining sector

Data: 5 Janar 2012

*Seminari u mbajt në Hotelin Swiss Diamond, në Prishtinë.*

*Qëllimi këtij seminari ka qenë përgatitja e stafit të Trepçës, AKP dhe KPMM, për trajnimin në Japoni, që është organizuar nga JICA.*

*Në seminar morën pjesë përfaqësuesit e JICA, JAAK dhe MMPH.*



*Gjatë seminarit janë paraqitur prezantimet nga çdo institucion i lartpërmendur.*